



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1311 Prot.

Tiranë, më 24.06 2026

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 92 dt. 24.06 2026

“PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “TRAJNIMI SPORTIV DHE TË USHQYERIT”, ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES DHE UNIVERSITETIT EVROPIAN TË MADRIDIT”

1. Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr.87 datë 24.06.2026 “Për miratimin e Rregullores së programit të përbashkët të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit Evropian të Madridit, shkresën nr. 606/7 prot., datë 23.06.2026 të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes “Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të përbashkët “Master profesional” në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”, Senati Akademik,

V E N D O S I :

2. Miratimin e Rregullores së programit të përbashkët të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Trajnimi Sportiv dhe të Ushqyerit”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të

Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Universitetit Evropian të Madridit.

3. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të UST-së, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

